

Ndihma Ekonomike: Përse duhet të pajtoheni me mbështetjen financiare për fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut?

Pyetje: Kujt i kërkohet të pajtohet me mbështetjen financiare për fëmijën?

Përgjigje: Legjislacioni federal dhe ai i shtetit të Nju-Jorkut kërkon që të pajtoheni me mbështetjen financiare për fëmijën kur keni një fëmijë minoren të përfshirë në buxhetin tuaj të ndihmës ekonomike dhe prindi tjetër i fëmijës (prindi jokujdestar) nuk është në këtë buxhet. Njoftoni punonjësën e Administratës për Pavarësinë e Familjes (Family Independence Administration (FIA)) nëse e keni tashmë një urdhër të mbështetjes financiare për të gjithë fëmijët e përfshirë në çështjen tuaj.

Pyetje: Çfarë ndodh nëse nuk pajtohem me mbështetjen financiare për fëmijën?

Përgjigje: Nëse nuk pajtoheni, përfitimet tuaja mund të reduktohen, siç tregohet më poshtë:

- Ndihma ekonomike për ju mund të reduktohet me të paktën 25%;
- Mund të humbisni shërbimet e Medicaid për veten;
- Mund të humbisni të drejtën e përzgjedhjes për disa programe të ndihmës për qiramarrje ose mund t'ju reduktohet mbështetja financiare për shpenzimet e qirasë;
- Nuk do të merrni pagesa të mbështetjes financiare për fëmijën deri në \$200 në muaj në shtesë të përfitimit tuaj të ndihmës ekonomike, as përfitime të tjera, pasi të humbni të drejtën për ndihmë ekonomike.

Pyetje: Kur dhe ku do të zhvillohet intervista ime për mbështetjen financiare për fëmijën?

Përgjigje: Shihni njoftimin e takimit të dërguar në këtë pako.

Nëse e keni humbur, ju nevojitet më shumë informacion, preferoni një takim virtual ose ju duhet ta ricaktoni takimin, kontaktoni zyrën lokale të zonës suaj për mbështetjen financiare për fëmijën. Gjeni zyrën lokale të zonës suaj në <https://on.nyc.gov/contactocss>. Për të ricaktuar një takim ose për të kërkuar takim virtual, na telefononi të paktën 24 orë më herët.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të të gjithë dokumenteve të referuara mund t'i gjeni në <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose përdorni kodin QR më poshtë.



Pyetje: A mund të përjashtohem nga mbështetja financiare për fëmijën?

Përgjigje: Më poshtë jepen disa shembuj të arsyeve përse dikush mund të përjashtohet nga mbështetja financiare për fëmijën, qoftë përkohësisht apo përgjithmonë. Edhe nëse bëni pjesë në një nga këto kategori, ju duhet t'i ndiqni takimet tuaja të mbështetjes financiare për fëmijën për të shpjeguar situatën tuaj dhe për të diskutuar hapat e mëtejshëm.

- Ju shqetësoheni për sigurinë tuaj dhe të fëmijëve tuaj nëse prindi tjetër thirret në gjykatë dhe urdhërohet të paguajë mbështetje financiare për fëmijën. Mësoni më shumë në <https://on.nyc.gov/custodialparent> nën seksionin “Marrja e mbështetjes financiare për fëmijën në mënyrë të sigurt”.
- Fëmija juaj ka ardhur në jetë nga një shtatzëni si pasojë e një incesti ose përdhunimi.
- Jeni duke punuar me një agjenci birësimi që fëmija juaj të birësohet.



Përpara se të shkoni te takimi juaj, lexoni “**Njoftimin mbi përgjegjësitë dhe të drejtat për mbështetjen financiare LDSS-4279**” dhe “**Informacionin për të gjithë aplikantët e mundshëm të mbështetjes financiare për fëmijën në lidhje me marrjen e mbështetjes financiare për fëmijën në mënyrë të sigurt W-280a**”. Nëse keni shqetësime në lidhje me sigurinë pas leximit të këtyre dokumenteve, kontaktoni punonjësin e FIA-së, i cili do t’ju referojë te një Koordinator i HRA-së për Dhunën në Familje. Së bashku mund të vendosni nëse marrja e mbështetjes financiare për fëmijën është një veprim i sigurt për ju dhe familjen tuaj.

Keni nevojë për ndihmë?

Vizitoni ose kontaktoni zyrën lokale të zonës suaj. Gjeni zyrën lokale të zonës suaj në <https://on.nyc.gov/contactocss>.

Kopjet dhe përkthimet e këtij dokumenti dhe të të gjithë dokumenteve të referuara mund t’i gjeni në <https://on.nyc.gov/custodialparent> ose përdorni kodin QR më poshtë.

